



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	
MINISTRI OT AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT	
Arhiv Qendror - Centralno Arhivo - Central Archive	
Nr./Br./No.	3327
Nr. i fq./Br. Str. No. pg.	3
Data/Datum/Data.	10.08.2023
PRISHTINE PRISTINA PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-293/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Talisman i prodhuesit “Galenika- Fitofarmacija a.d”, Serbi nga përfaqësuesi i saj “Agrohelpp-SA” SH.P.K, Rahovec.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Herbicid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Nicosulfuron.....40g/l

4. PËRDORIMI:

Talisman[®] është herbicid selektiv sistemik, që përdoret pas mbirjes së misrit. Përdoret për kontrollin e barërave të këqija njëvjeçare dhe shumëvjeçare në misër. Ky herbicid thithet nga bima nëpërmjet gjethëve dhe sistemit rrënjorë dhe lëviz në indet e rritjes të bimës në drejtim akropetal dhe bazipetal (nga ksilema në floemë). Talisman[®] Pengon sintezën e Acetolaktazës (ALS), bllokton ndarjen qelizore dhe rritjen e barërave të këqija.

Kultura	Doza	Koha e Aplikimit	Karenca PHI
Misër	1 – 1.5 l/ha Në 200-400 litra ujë	Nga faza dy deri gjashtë gjetheve	Nuk aplikohet

Barërat e këqija që kontrollojnë:

Emri i barit të keq	Emri Latin
Barërat e këqija gjethegjera	
Nena e përveshur	<i>Amaranthus retroflexus</i>
Shtrapër	<i>Capsella bursa-pastoris</i>
Minueri farorë	<i>Chenopodium polyspermum</i>
Tatulla	<i>Datura stramonium</i>
Minueri i bardhë	<i>Chenopodium album</i>
Bamja e egër	<i>Hibiscus trionum</i>
Hithërbuta e purpurt	<i>Lamium purpureum</i>
Nejça gjethe pjeshke	<i>Persicaria maculosa</i>
Fallopia dredhëz	<i>Fallopia convolvulus</i>
Manushaqja e arave	<i>Viola arvensis</i>
Gjethe delli	<i>Plantago major</i>
Veronika persiane	<i>Veronica persica</i>
Barërat e këqija gjethegushta	
Muhari	<i>Echinochloa crus-galli</i>
Kostreva	<i>Setaria viridis</i>
Meli i përgjakur	<i>Digitaria sanguinalis</i>
Talla	<i>Sorghum halepense</i>

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

1L, 5L

6. VËREJTJE:

Shume toksike për gjallesat ujore ku shkakton pasoja afate gjata te dëmshme. Mos ndotni ujerat dhe burimet ujore që rrjedhin ne lumenj, përrrenjtë e rezervuare uji.

7. KARENCA:

Nuk aplikohet



8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:

GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)



GHS09- paralajmerim (cat 1)-i rrezikshëm për ambient.

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- *Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;*
- *Shërbimi kufitar fitosanitar;*
- *Inspektorët fitosanitar AUV;*
- *Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Arkivit.*